

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

21.11.2016.

V E N D I M

I Komisionit për ankesa pranë Këshillit për etikë në mediat e Maqedonisë (KEMM) pas ankesës së Arijanit Xhaferit për tekstin me titull "Konfirmohet lajmi i Zhurnalit: z.Xhaferi "Rrena i ka këmbët e shkurta": Dhe tani pas faktit të dytë, dëshmi VIDEO prezenca juaj në mbledhjen e LSDM-së, çfarë do ti thuani popullit?", i publikuar më 07.10.2016, në portalin e Internetit Zhurnal (www.zhurnal.mk)

ANKESA ËSHTË E JUSTIFIKUAR

Është shkelur Neni 1, 10 dhe 13 i Kodit të gazetarëve të Maqedonisë.

Neni 1.

"Gazetari ka të drejtë për qasje të lirë gjer të gjitha burimet e informimit, të cilat janë në interes publik. Gazetari duhet të botojë informata të vërteta e të konfirmuara dhe nuk do të fshehë të dhëna esenciale ose të falsifikojë dokumente. Në qoftë se informata nuk mund të konfirmohet, ose nëse bëhet fjalë për supozim, respektivisht spekulim, kjo gjë duhet cekur dhe botuar. Saktësia e informatës duhet vërtetuar aq sa është e mundur."

Neni 10.

"Gazetari nuk ka për të krijuar ose përpunuar me vetëdije informata, të cilat i kërcënojnë të drejtat ose liritë e njeriut, nuk ka për të folur me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë ose diskriminim mbi çfarëdo lloj baze (kombëtare, fetare, racore, gjinore, shoqërore, gjuhësore, politike, orientimi seksual...)"



СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

Neni 13.

"Gazetarët duhet të bëjnë dallim ndërmjet fakteve dhe mendimeve, ndërmjet lajmit dhe komenteve."

ARSYETIMI

Më 20.10.2016, Arijanit Xhaferi parashtroi ankesë deri te Zyra ekzekutive e Këshillit për etikë në mediat e Maqedonisë për tekstin me titull "Konfirmohet lajmi i Zhurnalit: z.Xhaferi "Rrena i ka këmbët e shkurta": Dhe tani pas faktit të dytë, dëshmi VIDEO prezenca juaj në mbledhjen e LSDM-së, cfarë do ti thuani popullit?", i publikuar më 07.10.2016, në portalin e Internetit Zhurnal (www.zhurnal.mk).

Në ankesë thuhet se raportimi në këtë tekst është i pasaktë dhe i padrejtë.

Zyra ekzekutive e KEMM-it, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së Komisionit për ankesa, pas pranimit dhe shqyrtimit të ankesës, kontaktoi me portalin e internetit Zhurnal dhe kërkoi nga redaksia që të prononcohet lidhur me pretendimet në ankesë. Portali në fjalë nuk dërgoi përgjigje lidhur me pretendimet e ankuesit.

Komisioni për ankesa konstatoi se ankesa lidhur me përmbajtjen është e JUSTIFIKUAR.

Në seancën e datës 08.11.2016 година, Komisioni për ankesa shqyrtoi pretendimet e ankuesit, Arijanit Xhaferi, dhe inspektoi tekstin në fjalë.

Pikë së pari, anëtarët e Komisionit konstatuan se, edhe pse në tekst janë dhënë një sërë pikëpamjesh të autorit, autori nuk bën dallim midis fakteve dhe informacioneve ndërsa mendimin e toj e kamuflon si fakt. Për më tepër, në sytë e publikut ankuesi paraqitet në pozitë të nënshtruar,



СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

sepse prej tij, si palë në produktin gazetaresk, nuk është kërkuar mendim. Ky është imperativ bazik në gazetarinë profesionale.

Më tutje, Komisioni konstatoi se në tekst janë përdorur video dhe foto materiale të cilat nuk vijnë nga evenimenti, e për të cilat autori pretendon se janë nga kongresi partiak i LSDM-së, nga debati i organizuar nga partia e njëjtë politike, ku ai ka qenë i ftuar si folës. Kjo mund të shihet qartë nga video dhe foto materialet se në debat marrin pjesë edhe persona të tjerë të cilët nuk janë anëtarë të LSDM-së.

Etika në këtë produkt gazetaresk është shkelur edhe për faktin se ankuesi diskriminohet edhe më tej në bazë etnike dhe qytetare, dhe në përpjekje për ta zhvlerësuar atë, ai në mënyrë të padrejtë paraqitet si personalitet politik – anëtar i partisë politike LSDM, që në fakt është edhe e drejta e tij personale dhe qytetare, e garantuar me Nenin 20 të Kushtetutës së RM-së. Ky nen qytetarëve u garanton lirinë e bashkimit me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejtave dhe bindjeve të tjera.

Komisioni për ankesa konstatoi se teksti me titull “Konfirmohet lajmi i Zhurnalit: z.Xhaferi "Rrena i ka këmbët e shkurta": Dhe tani pas faktit të dytë, dëshmi VIDEO prezenca juaj në mbledhjen e LSDM-së, cfarë do ti thuani popullit?” i publikuar më 07.10.2016, në portalin e Internetit Zhurnal, është shkelur Neni 1 i Kodit të gazetarëve të Maqedonisë, sipas të cilit kontrollimi dhe saktësia e të dhënave janë imperativ moral i gazetarisë, dhe për këtë arsye, gazetari është i obliguar ta kontrollojë informacionin nga sa më shumë burime, së paku dy burime të pavarura. Gazetari duhet të sigurojë “palën e dytë”, respektivisht, t’u japë mundësi të gjitha palëve të prekura nga produkti gazetaresk që ta tregojnë qëndrimin e tyre. Kjo vlen në veçanti në rastet kur gazetari paraqet dyshime a akuza, ose kur dikush është subjekt i sulmit dhe kritikës.



СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

Komisioni konstatoi se është shkelur Neni 10, sipas të cilit gazetari dhe mediat janë të obliguar t'i mbrojnë individët dhe grupet nga padrejtësia dhe diskriminimi nga ana e organeve dhe institucioneve publike, nga ndërmarrjet private ose nga kushdo.

Komisioni konstatoi se është shkelur Neni 13, sipas të cilit gazetarët kanë të drejtë të mendimit, qëndrimit dhe gjykimit të vlerave, por nuk guxojnë ta kamuflojnë mendimin e tyre si fakte. Duhet qartë të bëhet ndarja e fakteve dhe informacioneve, komenteve dhe supozimeve a qëndrimit të autorit me qëllim që të shmanget keqinformimi dhe manipulimi me publikun.

Në përputhshmëri me këtë, Komisioni vendosi si në dispozitivin.

Në punën e Komisionit për aneksa morën pjesë anëtarët Mirçe Adamçevski, Filip Gjurginovski, Meri Jordanovska, Sefer Tahiri, Goce Gerasimovski, Teofill Bllazhevski dhe Bekim Ajdini.

Në përputhshmëri me Nenin 18 të Rregullores për punë të Komisionit për ankesa, obligohet portali i Internetit Zhurnal (www.zhurnal.mk) që ta publikojë vendimin e Komisionit për ankesa.

Me respekt,
Këshilli për etikë në mediat e Maqedonisë

Kryetar i Komisionit për ankesa
Mirçe Adamçevski

